



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	30.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3153/2022		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.418/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.418/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë: kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.418/2022 e datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

**II.MBETET** në fuqi Vendimi me numër protokolli 177/2022 i datës 07.02.2022, i nxjerrë nga Zv. i Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

**A r s y e t i m**

Ankueses e punësuar ne Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, pozitën “Zyrtare për verifikimin e stazhit”, në Divizionin për Pensione të Jashtme në kuadër të Departamentit të Pensioneve, me date 07.02.2022 zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nxjerr Vendimin me numër protokolli 177/2022, me te cilin vendim i përfundon marrëdhënia e punës nga data 23.02.2022, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, dhe po ashtu me këtë vendim ankuesit i njihet e drejta e kompensimit të një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Me datë 28.02.2022 ankuesja ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për kompensimin e tri(3) pagave përcjellëse duke u bazuar në dispozita e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës,perkatesisht nenin 76 paragrafin 7 nën paragrafin 7.3 dhe nenin 77.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereven nuk i pergjegjet ne kërkesën e datës 28.02.2022, andaj ankuesja kunder heshtjes administrative të organit te punesimit me datë 26.04.2022 parashtron ankesë me numër protokolli 2366/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim të tri (3) paga përcjellëse sipas dispozitave te Ligjit të Punës, gjegjesisht kerkon kompensimin në bazë të punës dhe përkushtimit të saj për vitet që ka kontribuar në ministri.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Më datë 11.05.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë përmes e-mailit zyrtar nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me shkresat e bashkangjitura .

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike,** për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Anr.418/2022 të datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokollit 177/2022 i datës 07.02.2022 të nxjerrë nga zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Kërkesë e datës 28.02.2022 drejtuar Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Financave, Punës dhe Transfereve; Përgjigje në ankesë e datës 11.05.2022 përmes e-mailit zyrtar nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; E-mail i datës 11.05.2022; Formulari i të dhënave për listë të pagave-pagesës retroaktive e datës 01.02.2022; Lista e pagave nga data 01.02.2022 deri me datë 28.02.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka pranuar ankesën e datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesja ka konstatuar se ankesa e ankueses është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 127 paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që ka përcaktuar se: *“3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”*, lidhur për faktin se Vendimi i datës 07.02.2022 i nxjerrë nga zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, nuk ka përfshirë mjetet juridike administrative në këtë vendim, që në fakt ankuesja në Këshill ka parashtruar ankesë me pretendimet e saja, kundër heshtjes administrative, sipas Kërkesës së datës 28.02.2022, për të cilën çështje me rastin e ushtrimit të ankesës është bazuar në dispozitën ligjore të nenit 125 të njëjtit ligji, lidhur me rregullat e përgjithshme dhe kushtet e pranueshmërisë së ankesës.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi që ka konstatuar se ankesa e ankueses është e afatëshme, ka analizuar pretendimet ankimore, e cila ka pretenduar që të bëhet kompensimi i tri (3) pagave përcjellëse duke i specifikuar dispozitat ligjore të të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, respektivisht nenin 76 paragrafin 7 nën paragrafin 7.3 dhe nenin 77, për njohjen e kompensimit të menjëhershëm, në të holla (para) sipas kontratës për të punësuarit me periudhë të pacaktuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesja e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në pozitën *“Zyrtare për verifikimin e stazhit”*, në Divizionin për Pensione të Jashtme në kuadër të Departamentit të Pensioneve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesja ka qenë nëpunëse civile në I Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe që statusi i nëpunësve civilë si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet, rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe akteve përkatëse nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pagat, shtesat në pagë dhe kompensimet e pagës për nëpunësit civilë, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si

dhe të akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji, me të cilat përveç tjerash në mënyrë decisive përcaktohet edhe kompensimi i nëpunësve civilë me rastin e arritjes së moshës së pensionimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë është përcaktuar që nëpunësit civilë, përveç tjerash kanë të drejtat në vijim:.... „**2.2. pagesën për shkak të pensionimit dhe 2.3. shpërblimi i përvjetorit (jubile).**”

Po ashtu me dispozitat e nenit 19 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, është përcaktuar që: „**Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit**”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të ofruara nga organi i punësimit, gjegjësisht listës së pagave, konstaton që ankueses i është bërë kompensimi në shumën bruto prej 432.18 Euro, si pagesë në shumën e një page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka kërkuar dëshmi për pagesën e ditëve të punës në muajin shkurt 2022, dhe në bazë të provave gjegjësisht listës së pagave, konstaton që ankueses, për ditët e punës nga data 01.02.2022 deri me 23.02.2022, i është bërë kompensimi në shumën bruto prej 339.47 Euro.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh faktet e lartcekura konstatoi që ankueses i është bërë kompensimi me rastin e pensionimit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil, dhe për këtë arsye vendosi të refuzoj ankesën si të pabazuar, pasi që kërkesa për pagesën e tri pagave përcjellëse duke i specifikuar dispozitat ligjore të të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, respektivisht nenin 76 paragrafin 7 nën paragrafin 7.3 dhe nenin 77, ka të beje me kompensimin e menjëhershëm në para, që duhet tu paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, respektivisht tek largimet kolektiv nga puna, e këto dispozita nuk zbatohen për nëpunësit civil për cilët vlejnë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe akteve përkatëse nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 07.02.2022 me numër protokoll 177/2022 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit për ankuesin.

si dhe njohjen e kompensimit e një page pas moshës së pensionimit, për nëpunësen civile është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marrë në bazë të dispozitave ligjore përkatësisht nenit 60 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik , që përcaktohet se: “ **1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur:.....1.3. plotësohet moshja për pensionim**” si dhe Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

ka nxjerr Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të datës 01.02.2021 me numër 01Nr.01-10/2021 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me të cilin vendim ankuesit i njihet e drejta e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit pas moshës së pensionimit, sipas dispozitave ligjore të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime dhe Kolegji në bazë provave të lëndës ka konstatuar se ankuesit iu është bërë pagesa në vlerë prej 446.26 Euro (katërqind e katër te gjashtë Euro e njëzet e gjashtë cent) në bazë të Kërkesës për Pagesë Retroaktive të datës 08.06.2021.



Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se me Vendimin me numër protokolli 177/2022 të datës 07.02.2022 të nxjerrë nga zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ankueses i është njohur e drejta e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit pas moshës së pensionimit, sipas dispozitave ligjore përkatësisht nenit 22 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: *'2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim:....2.2. pagesën për shkak të pensionimit'*, si dhe me dispozitat ligjore të nenit 19 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera në Shërbimin Civil, që përcaktohet se: *'Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëherëshme në vlerën e pagës së fundit'*, andaj Kolegji në rastin konkret bazë provave të lëndës ka konstatuar se ankueses iu është bërë pagesa në vlerë prej 432.18 Euro, si pagesë në shumën e një page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.418/2022.

Zyle Millaka GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së.